

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENSIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE ARSIMORE KUKËS

Nr. 5894 Prot.

Kukës, më 26.08 2025

NJOFTIM

Për shpalljen e konkursit për vendin vakant të nëndrejtorit të shkollës “Lidhja e Prizrenit” Kukës

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 27.2.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor publik parauniversitar", shkresës të shkollës “Lidhja e Prizrenit” Kukës Njoftim Nr 64 Prot datë 25.08.2025 , Zyra Vendore Arsimore Kukës shpall konkursin për pozicionin :

Nëndrejtor Shkolle në Shkollën 9-vjeçare “ Lidhja e Prizrenit”, Kukës .

Kriteret

1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e nëndrejtorit në IAP përmban :
 - jetëshkrimin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, udhëzim 22);
 - kopjen e librezës së punës;
 - kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
 - tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, udhëzim nr 22 ;
 - certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon;
 - vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, Udhëzimi 22);

- vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- deklaratën për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 8, Udhëzimi 22
- deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, Udhëzimi 22

Afati i aplikimit:

- Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në IAP “Lidhja e Prizrenit” Kukës për kandidatin për nëndrejtor.
- Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se dhjetë ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTOR
KRESHNIK GËRBOLLI**

